



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Data/nr	16.04.2026 <u>01-052/01-17797</u>
Për:	Shefqet Shehu, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Gjakovës
CC:	- Të gjithë anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Gjakovës - Arkivit
Nga:	Ardian Gjini, Kryetar i Komunës së Gjakovës
Lënda:	Propozim vendim për shqyrtim dhe miratimin e Raportit të komisionit komunal për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në Komunën e Gjakovës të viti 2025



Të nderuar,

Kryetari i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 58 shkronja h të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 46 shkronja h të Statutit të Komunës së Gjakovës, dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-027 për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera, si dhe dispozitave të Rregullores (QRK) Nr. 17/2015 për Metodologjinë e Vlerësimit të Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera, me datën 16.04.2026 e parashtron në Kuvendin e Komunës së Gjakovës këtë:

P R O P O Z I M V E N D I M

1. Kuvendi i Komunës së Gjakovës të shqyrtoj dhe miratojë Raportin e Komisionit Komunal për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera të nxjerrë me datë 25.02.2026.
2. Pjesë përbërëse e këtij propozim - vendimi janë: Raporti i Komisionit Komunal për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, në periudhën e vitit 2025 të shkaktuar nga stuhia e rrëmbyeshme, goditje nga rrufesë.
3. Obligohen organet e administratës për kryerjen e të gjitha procedurave në harmoni me gjitha aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova



GJAKOVA
Komuna e Gjakovës
Opština Djakovica
Municipality of Gjakova

08-ZYRTARISHT

DATË/A:	25.02.2026
PËR/ZA/TO:	z. Ardian Gjini-Kryetar i Komunës së Gjakovës z. Shefqet Shehu-Kryesues i Kuvendit të Komunës së Gjakovës w
KOPJE/A/CC:	
NGA/OD/FROM:	Anëtarët e Komisionit : Robert Marjakaj Taulant Bakalli Dafina Thaqi Milot Bejtullahu Samir Sylmetaj
PËRMES/PREKO/THROUGH:	z. Gani Hajdari - Drejtor i Drejtorisë për Bujqësisë, Pylltari dhe Zhvillimit Rural.
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raport për vlerësimin e dëmit të shkaktuar nga fatkeqësitë natyrore rrufeja-vetëtimja.

Të nderuar,

Mbështetur në kërkesën e fermerit në lidhje me dëmin e shkaktuar nga fatkeqësitë natyrore-rrufeja me datë: 22.08.2025, komisioni me:01nr.112/02-44913, i formuar nga zyra e kryetarit, menjëherë ka filluar punën në terren.

Në Komunën e Gjakovës gjegjësisht në fshatin Berjahë, me datën 22.08.2025, si pasojë e një stuhie të rrëmbyeshme nga goditja e rrufës fermerit Agron Syla me numër të NIF-1004499, i ngordhin dy nga 23 gjedhet qumështore sa ishin duke kullotur në livadhet fshatit.

Gjatë punës në teren komisioni ka kontaktuar fermerin ku i janë kërkuar fotot e gjedheve të ngordhura, procesverbalin e Inspektorit veterinar, raportin e Mjekut veterinar, si dhe dokumentet tjera relevante lidhur me rastin.

Komisioni pasi ka verifikuar gjendjen faktike nga tereni, ka përgatitur raportin vlerësues.

Dëmi i shkaktuar është llogaritur në bazë të çmimeve të tregut.

Vlera e dëmit:

- Dy gjedhe qumështore të ngordhura
- Totali i dëmit: 5600 €

Andaj, propozojmë që ky raport të hyjë si pikë e rëndit të ditës në mbledhjen e radhës të Asamblesë Komunale për aprovim, dhe i njëjti pasi të aprovohet ti dërgohet komisionit qendror për vlerësim e dëmeve në kuadër të AME, bazuar në rregulloren (QRK)-NR.17/2015.





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSO
KUVENDI KOMUNAL GJAKOVË

OPŠTINA DJAKOVICA / MUNICIPALITY OF GJAKOVA



GJAKOVA

**RAPORT I KOMISIONIT KOMUNAL PËR VLERËSIMET E DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA FATKEQËSIT NATYRORË-
RRUFEJA**

Emri dhe mbiemri:	Agron Sylla	Nr telefonit:	
Nr personal:		Kërkesa e fermerit e protokollar ne komunë (nr dhe data):	08-320/01-45042
NIF (nese posedon):		Shkaktari i dëmit	Rrufeja
Adresa:	Fshati Berjähë	Data e fatkeqësisë natyrore:	22.08.2025
Komuna:	Gjakovë	Data e vlersimit nga komisioni:	25.08.2025

Nr	Emërtimi i dëmit të shkaktuar (kultura bujqësore, kafshët, shpezët) dhe foli serre	Sipërfaqja në / ha; nr. i krerëve kafshëve, shpezëve dhe koshereve të bletëve,	Rendimenti mesatar për 1 ha (kg) sipas udhëzuesit	Totali I rendimentit (c x b=e)	% dëmit	Rendimenti i dëmtuar (e x f=g), nr. i krerëve kafshëve, shpezëve dhe koshereve të bletëve të dëmtuar dhe foli serrave (kg)	Cnimi mesatar sipas udhëzuesit	Totali Euro
a	b	c	d	e	f	g	h	i
1	Gjedhë	2					2800	5,600.00
Totali:								5,600.00

Anëtarët e komisionit:

- 1 Robert Mariakaj - kryesues
- 2 Taulant Bakalli - anëtar
- 3 Dafina Thaqi - anëtar
- 4 Milot Bejtullahu - anëtar
- 5 Samir Sylmetaj - anëtar